REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.48, datë 16/09/2005

PËR
MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LIMITIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE PËR INVESTIMET E VITIT 2005, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT PËRMIRËSIM I PAISJEVE DHE ORENDIVE TË SHKOLLËS 9-VJECARE "MUSTAFA GREBLLESHI" SAUK, NGA GRANTI JAPONEZ"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "dh", ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës", neni 8, gërma "g", ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ndryshuar me ligjin Nr.8399, datë 09/09/1998 "Për disa ndryshime në ligjin Nr.7776, dt.22/12/1993 "Për buxhetin lokal", ligjit Nr.7892, dt.21/12/1994 "Për sponsorizimet", ndryshuar me ligjin Nr.8282, dt.21/01/1998, Akt-Marrëveshjes së lidhur me datë 16/06/2005 ndërmjet Ambasadës Japoneze dhe Bashkisë së Tiranës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shtesën e limitit të të ardhurave për investimet në Bashkinë e Tiranës për vitin 2005 në shumën 5 852 538 lekë.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të miratohet fondi prej 5 852 538 lekësh për financimin e Projektit "Blerje paisjesh dhe orendish për shkollën 9-vjecare "Mustafa Grebllesh" Sauk, sipas Akt-Marrëveshjes të lidhur me datën 16/06/2005 ndërmjet Ambasadës Japoneze dhe Bashkisë së Tiranës.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore (Sektori i Politikave Arsimore), Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI